



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 25 shkurt 2021

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të KPK/Nr.49/2021, të datës 25 shkurt 2021, publikon:

SHPLLJE E BRENDSHME

I. Për transferimin e përhershëm dhe avancimin e prokurorëve të Shtetit si në vijim:

- 1) Një (1) pozitë për prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
- 2) Një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Gjakovë;
- 3) Një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Pejë;
- 4) Një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
- 5) Dy (2) pozita për prokurorë në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë;
- 6) Një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë;
- 7) Një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

II. Prokurorët e Shtetit duhet të plotësojnë kriteret e veçanta për transferim të përhershëm dhe avancim në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokuroritë Themelore në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj dhe Mitrovicë si në vijim:

- për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda apo në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë mandat të përhershëm si prokuror dhe vlerësim pozitiv të performancës;
- për të ushtruar funksionin e prokurorit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, prokurori duhet të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë si prokuror si dhe bazuar në vlerësimin e performancës;

III. Përveç kriterëve të veçanta, prokurorët e Shtetit duhet të plotësojnë edhe këto kriterë:

- Të kenë mandat të përhershëm;
- Të kenë vlerësim pozitiv të performancës;
- Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit dhe vërejtjes jo publike;

TRANSFERIMI I PËRHERSHËM I PROKURORËVE TË SHTESTIT

- IV. Komisioni me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm, përveç kriterëve të cekura në pikën II merr parasysh edhe përvojën e punës dhe vendbanimin.
- V. Me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm merret edhe mendimi i kryeprokurorit të prokurorisë nga e cila kërkohet transferimi.
- VI. Prokurorët e Shtetit duhet të parashtrojnë kërkesë¹ për transferim të përhershëm.

AVANCIMI I PROKURORËVE TË SHTESTIT

- VII. Prokurorët e shtetit duhet të parashtrojnë kërkesë² për avancim.
- VIII. Kërkesës për avancim duhet t'i bashkëngjisin edhe dokumentet si në vijim:
- Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 - Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
 - Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivi të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.
- IX. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
- X. Shpallja është e hapur për të gjithë prokurorët e Shtetit të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara si më lart.
- XI. Kërkesa duhet të dorëzohet në Këshillin Prokurorial të Kosovës, nga data **1 mars deri më 15 mars 2021** tek Koordinatorja për emërim, avancim dhe transferim, znj. Ismije Maxhuni kati i III, zyra numër 306, objekti i Prokurorit të Shtetit në Prishtinë, rruga "Luan Haradinaj", të mbyllura në zarf, ose me postë.

¹ Kërkesa për transferim të përhershëm duhet të përmbajë arsyen për transferimin e përhershëm të prokurorit të Shtetit e cila përgatitet nga vet prokurorët e Shtetit si dhe informatat se nga cili Departament i cilës prokurori kërkon transfer të përhershëm në cilin departament të nivelit të njëjtë të cilës prokurori.

² Kërkesa për avancim duhet të përmbajë arsyen për avancim të prokurorit të Shtetit e cila përgatitet nga vet prokurorët e Shtetit si dhe informatat se nga cili Departament i cilës prokurori kërkon avancim në cilin departament të cilës prokurori duke i bashkëngjitur dokumentete e kërkuara me Rregullore.